



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr. 715/2 prot.

Tiranë, më 12. 06. 2024

VENDIM

Nr. 10, Datë 12 / 06 / 2024

PËR MIRATIMIN E TABELAVE TË REZULTATEVE PËRFUNDIMTARE PËR ZGJEDHJEN E AUTORITETEVE DREJTUESE DHE SENATIT AKADEMIK NË UNIVERSITETIN E ARTEVE, MËNYRËS SË PËRLLOGARITJES SË REZULTATEVE DHE VULOSJES SË FLETËVE TË VOTIMIT

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, të Urdhrit nr. 101, datë 13.03.2024 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”, të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik në Universitetin e Arteve”, miratuar me VSA nr. 17, datë 29.03.2024, Komisioni Institucional i Zgjedhjeve, pasi diskutoi mbi to, me votim të hapur,

VENDOSI:

1. Miratimin e tabelave të rezultateve përfundimtare të zgjedhjes së autoriteteve drejtuese dhe Senatit Akademik, sipas formateve bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Mënyra e përllogaritjes së votave për autoritetet drejtuese, për të cilat votojnë edhe studentë, do të jetë varianti A, parashikuar në Rregulloren e Zgjedhjeve, neni 35, pika 10, shkronja a.
3. Vula e KIZ do të vendoset në pjesën e pasme të fletës, djathtas lart.
4. Vula e KZF-ve përkatëse, sic parashikohet në Rregullore, do të vendoset në pjesën e pasme të fletës, majtas lart.




5. Ky vendim të dërgohet pranë Komisioneve Zgjedhore të Fakulteteve të Universitetit të Arteve.

6. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare elektronike të UART.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar

Orges Malaj



Anëtar

Shpëtim Kërçova




Anëtar

Suela Agolli



Anëtar

Adela Kusuri



Anëtar

Sara Caca



Sekretar

Redjan Mulla

